



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE
SEKTORI I ARSIMIT, RINISË DHE SPORTIT

Nr. 3604 prot.

Vlorë, më 20.02 2026

PROJEKTVENDIM

Nr _____, Datë _____.2026

**“PËR ZGJERIMIN E FASHËS SË NXËNËSVE EKSELENT TË PËRFSHIRË NË
BONUSIN E EKSELENCËS PËR VITIN 2026”**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 100, datë 23.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2026”;

VENDOSI:

1. Mbështetjen e nxënësve që plotësojnë kriteret e bonusit të ekselencës duke përfshirë për herë të parë në këtë skemë edhe nxënësit e klasës së VII (shtatë) të ciklit 9-vjeçar dhe klasës së X (dhjetë) të shkollave të mesme publike të cilët kanë arritur mesataren vjetore 10.00.
2. Miratimin e bonusit të ekselencës për nxënësit me mesatare 10.00 të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme publike që janë në juridiksionin e Bashkisë Vlorë me vlerë:
 - a. **18.000 lekë për shkollat 9-vjeçare (publike)**
 - b. **30.000 lekë për shkollat e mesme (publike)**
3. Ky fond do të përballohet nga fondet e Buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2026.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij projektvendimi Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore.
5. Ky Vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55, pika 6.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE
SEKTORI I ARSIMIT, RINISË DHE SPORTIT

Nr. 3604 prot.

Vlorë, më 20. 02 2026

RELACION

**“PËR ZGJERIMIN E FASHËS SË NXËNËSVE EKSELENT TË PËRFSHIRË NË
BONUSIN E EKSELENCËS PËR VITIN 2026”**

Në mbështetje të Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.100, datë 23.12.2025, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2026”, paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi për zgjerimin e fashës së nxënësve ekselent të përfshirë për bonusin e ekselencës për vitin 2026.

Bashkia Vlorë e konsideron arsimin prioritet dhe vlerësimin e nxënësve ekselentë si një investim të drejtpërdrejtë në cilësinë e arsimit dhe në motivimin e brezit të ri. Vitin e kaluar 2024-2025 Bashkia Vlorë ka akorduar një fond për shpërblimin e plotë të nxënësve të ciklit 9-vjeçar publik i cili arrin në 2,800,000 lekë, ndërsa për ciklin e mesëm publik në 4,800,000 lekë, me një total prej 7,680,000 lekësh.

Në këto kushte, për të mbështetur nxënësit që plotësojnë kriteret dhe për të zbatuar vendimarrjen e Bashkisë Vlorë ka vendosur të zgjerojë fashën e përfituesve të bonusit të ekselencës për vitin 2026, duke përfshirë edhe nxënës të klasës së VII të ciklit 9-vjeçar publik dhe klasës së X të shkollave të mesme publike të cilët kanë arritur mesatare 10.00.

Për këtë qëllim, Bashkia Vlorë ka kërkuar informacion zyrtar nga institucionet arsimore përkatëse lidhur me numrin e nxënësve që plotësojnë kriterin e mesatares 10.00. Nga të dhënat e raportuara rezultojnë se numri i përfituesve për vitin 2025-2026 të cilët e përfitojnë bonusin me dëftesën e një viti më parë është 210 nxënës në ciklin 9-vjeçar publik dhe 220 nxënës në ciklin e mesëm publik.

Bazuar në këtë zgjerim të fashës së nxënësve përfitues, fondi i nevojshëm për shpërblimin e plotë të nxënësve të ciklit 9-vjeçar arrin në 3.780.000 lekë, ndërsa për ciklin e mesëm në 6.600.000 lekë, me një total prej 10,380,000 lekësh.

Nga ky fond 2.700.000 lekë shkojnë për klasat e VII dhe X të cilat futen për herë të parë në fondin për nxënësit ekselent.

Në këto kushte, për të garantuar trajtim të barabartë për të gjithë nxënësit që plotësojnë kriteret dhe për të zbatuar vendimmarrjen e Bashkisë Vlorë për zgjerimin e skemës së përfitimit, paraqitet për miratim shtesa e fondit në shumën 2.700.000 lekë, e cila do të përballohet nga fondet e buxhetit të vitit 2026.

Për sa më sipër, propozohet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për zgjerimin e fashës së nxënësve ekselent të përfshirë në bonusin e ekselencës për vitin 2026”.

Tabela e fondeve për bonusin e ekselencës viti 2025- 2026

Cikli	Nr. aktual	Shtesa në nr.	Fondi fillestar (lekë)	Fondi aktual (lekë)	Shtesa fondi (lekë)
9-vjeçar	210	+50	3,780,000	2,880,000	900.000
E mesme	220	+60	6,600,000	4,800,000	1.800.000
Totali	430	+110	10,380,000	7,680,000	2.700.000

Drëjtor
Loreta Nebiu